Republika e Maqedonisë së Veriut

Agjencia për Zbatimin e Gjuhës së RMV-së

Konferencë Shkencore Ndërkombëtare

SHUMËGJUHËSIA DHE SFIDAT E ZBATIMIT TË LIGJIT TË PËRDORIMIT TË GJUHËVE NË RMV

20-23 shkurt 2020

Organizuar nga:

AGJENCIA PËR ZBATIMIN E GJUHËS E RMV-së

www.apj.gov.mk

www.azgj.gov.mk

PËRMBAJTJA

Këshilli shkencor 5

Këshilli organizativ 5

Libri i abstrakteve 6

Pjesëmarrësit e konferencës 55

Këshilli shkencor

Xhevat Lloshi
Rami Memushaj
Emil Lafe
Shaban Sinani
Qemal Murati
Izer Maksuti
Asllan Hamiti
Ajten Hajdari - Qamili
Zeqiria Ibrahimi
Berton Sulejmani
Mustafa Ibrahimi
Marjan Patlixhankovski

Këshilli organizativ

Ylber Sela
Renata Asani
Nebi Bilalli
Ahmet Selmani
Enver Beqiri
Nerxhivane Kuqi
Llazo Matovski
Lirim Shabani
Ariton Spahiu

LIBRI I ABSTRAKTEVE

Izer MAKSUTI

MBI PËRDORIMIN E GJUHËS SIPAS MODELEVE TË POLITIKËS GJUHËSORE TË TIROLIT TË JUGUT DHE BELGJIKËS

Qëllimi i kësaj kumtese është të japë një pasqyrë mbi përdorimin e gjuhës në domenet e ndryshme si: në administratë, gjyqësi, shëndetësi etj., sipas modeleve të politikës gjuhësore të Tirolit të Jugut dhe Belgjikës.

Shembujt e përdorimit të gjuhës do të jepen për modelin e autonomisë gjuhësore në Tirolin e Jugut dhe modelin e federalizmit gjuhësor në Belgjikë, vetëm për pjesën e përdorimit të gjuhës gjermane atje.

Me interes do të jetë tërheqja e paraleleve në mes të këtyre dy modeleve dhe rastit të përdorimit të gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Fjalët kyç: Politika gjuhësore, autonomia gjuhësore, federalizmi gjuhësor, Tiroli i Jugut, Belgjika, përdorimi i gjuhës në domenet e ndryshme, shumëgjuhësia

Ajten HAJDARI - QAMILI

NEVOJA E NJËSIMIT TË TERMINOLOGJISË ADMINISTRATIVE DHE PËRFSHIRJA E TYRE NË FJALORËT TERMINOLOGJIKË

Abstrakt

Që me fillimin e përdorimit të pjesshëm të shqipes në administratë me zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit në vitin 2001, pastaj me avancimin e përdorimit të shqipes në vitin 2008 dhe me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve në vitin 2017, shqipja filloi të gjejë shprehje më të madhe dhe të përdoret në një numër të madh në institucionet publike. Së pari filluan të ndryshohen mbishkrimet e institucioneve, pastaj edhe disa nga shkresat zyrtare, kurse në komunat shqiptare edhe shkresat e tjera.

Në vitin 2019 disa nga institucionet kërkuan ndihmë nga AZGj-ja për t'ua përkthyer këto shkresa dhe mbishkrime, për shkak të mungesës së përkthyesve në ato institucione, por edhe për shkak të pasigurisë se cilin nga termat duhet përdorur.

Ajo që është vërejtur brenda këtyre 19 viteve, është se vështirësi më të mëdha gjatë përkthimit të këtyre shkresave kanë shkaktuar termat e larmishëm, shpesh sinonime të plota, por edhe të pjesshme që përdoren ndryshe në Shqipëri, ndryshe në Kosovë dhe ndryshe në Maqedoninë e Veriut. Në Shqipëri në terminologjinë administrative më shumë ka ndikuar italishtja dhe kohëve të fundit edhe anglishtja, kurse në Kosovë dhe në RMV, më shumë kanë ndikuar gjermanishtja dhe gjuhët sllave. Kjo është arsyeja që terminologjia nuk është e njësuar.

Në këtë kumtesë do të trajtoj vetëm disa nga termat që janë më problematikë, shumica sinonime të plota, të cilët mund të jenë si pikënisje e njësimit të terminologjisë administrative mbarëkombëtare. Kështu që, nga këtu detyrë kryesore e albanologëve do të jetë njësimi i terminologjisë administrative, të përcaktohen qartë e mirë, duke argumentuar se cili term duhet përzgjedhur, por në qoftë se nuk mund të njësohet për arsye jashtëgjuhësore, atëherë të sqarohet pse. Më pas, me të gjitha shpjegimet të futen në fjalorët elektronikë dhe në softuerin që do të përpilojë AZGJ-ja, që pastaj të përhapen në të gjitha trojet ku përdoret shqipja.

Fjalët kyç: njësim, terminologji administrative, fjalorë elektronikë, mbarëkombëtar.

Petra MALFERTHEINER

KUPTIMI I TË DREJTAVE TË GJUHËS NË TIROLIN E JUGUT PËRDORIMI I GJUHËS NË GJYKATA DHE NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

Abstrakt

Përveçse është një mjet për të shkëmbyer mesazhe, gjuha është një instrument i identifikimit individual dhe kolektiv dhe i shqiptimit kulturor. Me tre grupet e tij kryesore gjuhësore lokale, Provinca e Bolzanos/Bozen (Tiroli i Jugut), është ndër rajonet ku të drejtat gjuhësore janë më të zhvilluara, dhe gjatë dekadave të fundit, këto të drejta janë dëshmuar si një gurthemel për të garantuar bashkëjetesën paqësore.

Vendosja institucionale dhe politikat më autonome në Provincën e Bolzano Bozen, karakterizohen në mënyrë transversale nga një sistem i ndarjes së energjisë bazuar në ndarjen dhe bashkëpunimin e dy grupeve kryesore gjuhësore, komuniteteve gjermane dhe italishtfolëse, deri diku grupi Ladinfolës.

Që nga Marrëveshja e Parisit e vitit 1946, politikat që kanë të bëjnë me të drejtat e gjuhës janë rishikuar vazhdimisht, zhvillohen dhe azhurnuar më tej ashtu si qëllimet e tyre kanë ndryshuar. Në fakt, ndërsa qëllimi fillestar konsistonte në kundërveprimin e padrejtësive të mëparshme ndaj komunitetit gjermanofolës, që kishte origjinën nga periudha fashiste, sot mbrojtja e të drejtave gjuhësore në Tirolin e Jugut nuk është duke humbur rëndësinë e saj jetësore dhe mbetet një çështje e

diskutueshme, e debatuar ashpër, pika më e diskutueshme është akti delikat balancues midis ndarjes gjuhësore dhe integrimit.

Në këtë kontekst, korniza ligjore ka kontribuar në lehtësimin e tensioneve midis grupeve gjuhësore dhe vendosjen dhe zgjerimin e dygjuhësisë në sektorin publik, duke krijuar një administratë vërtet dygjuhëshe.

Në veçanti, prezantimi hedh dritë mbi përdorimin e gjuhëve në lidhje me gjyqësorin dhe organet e administratës publike në këtë krahinë ku dy gjuhë, gjermanishtja dhe italishtja, janë në baza të barabarta dhe ku një gjuhë e tretë bashkëjeton, dhe ekzaminon disa rrethana shembullore në këto fusha specifike.

Besim KABASHI

NDËRTIMI I KORPORATAVE PARALELE PËR NXJERRJEN E TERMINOLOGJISË PËR GJUHËN SHQIPE

Abstrakt

Ne paraqesim një propozim për ndërtimin e korporatave paralele me qëllim përdorimin e tyre si bazë për nxjerrjen e terminologjisë për gjuhën shqipe. Gjuha shqipe flitet në disa vende dhe ka statusin e një gjuhe zyrtare, p.sh. në Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë Veriore, lokalisht në Mal të Zi. Për më tepër, shqipja është një gjuhë e njohur e pakicave në vendet e tjera si Serbia, Kroacia, Italia, Rumania etj.

Ky diversitet gjeografik çon në ekzistencën e terminologjive të ndryshme në shqipen e folur; duke shkaktuar nevojën e korporatave paralele për të normalizuar variantet ose për të përcaktuar marrëdhëniet e termave të ndryshëm me njëri-tjetrin.

Nga njëra anë, ekziston nevoja për të mbledhur tekste nga Shqipëria dhe Kosova ku tekstet shqipe p.sh. tekstet juridiksionale, nuk kanë nevojë të përkthehen nga një gjuhë tjetër në gjuhen shqipe.

Nga ana tjetër, tekstet nga vendet si Serbia ose Mali i Zi duhet të mblidhen, ku zakonisht janë përkthyer nga gjuha zyrtare, e gjuhës serbe ose malazeze. Maqedonia e Veriut është një rast i veçantë pasi vitet e fundit statusi i shqipes është avancuar në një

gjuhë bashkë-zyrtare në shumë fusha në nivelin shtetëror dhe plotësisht në komunat me një popullsi shqipfolëse prej mbi 20%.

Ndërtimi dhe përdorimi i korporatave të varianteve njëgjuhëshe, dy ose shumëgjuhëshe, siç ilustrohet nga vendet e emëruara, është e paçmueshme për të krahasuar përdorimin e termave në kontekste të ndryshme (dhe burimet / vendet); duke ndihmuar kështu në përcaktimin e tyre, si dhe për të vëzhguar ndryshimet mbi kontekstet dhe kohën.

Andrea ABEL

GJUHA DHE EDUKATA GJUHËSORE NË SHKOLLAT E TIROLIT JUGOR: MUNDËSITË DHE SFIDAT

Abstrakt

Tiroli i Jugut (Itali) është i njohur si një rajon shumëgjuhësh, ku bashkëjetojnë tri grupet gjuhësore, gjermanishtja, italishtja dhe ladinishtja. Përdorimi i gjuhëve përkatëse në hapësirën publike është i rregulluar me ligj, me qëllim që të garantojë të drejtat gjuhësore për folësit e gjermanishtes, po ashtu edhe për bashkësinë e folësve të ladinishtes, e cila ka ardhur si pasojë e aneksimit të Tirolit Jugor nga Italia pas Luftës së Parë Botërore dhe të periudhës fashiste me politikën e saj të italianizimit të detyruar.

Përveç të tjerash, kujdesi për të drejtat gjuhësore dhe sistemin arsimor, që do të thotë përdorimin e gjuhëve në shkolla, mësimin e saj dhe arsimimin e mësuesve. Në fjalën tonë, do të paraqesim disa koncepte të shumë gjuhësisë që kanë të bëjnë me gjendjen në nivel lokal. Ne do t'i përshkruajmë gjuhët në kontekstin e tyre historik. Gjithashtu, do ta paraqesim sistemin shkollor të Tirolit Jugor. Nga kjo pikëpamje, vëmendje e posaçme i është kushtuar strukturës trepalëshe të sistemit shkollor dhe të karakteristikave të tij.

Përveç kësaj, ne diskutojmë edhe për modelet shkollore njëgjuhëshe dhe shumëgjuhëshe dhe zbatimin e tyre në kontekstin lokal, duke pasur parasysh zhvillimet më të reja që kanë të bëjnë me shumë llojshmëritë gjuhësore në shkollë, të cilat e sfidojnë sistemin e themeluar tradicional.

Emil LAFE

SFIDA TË SHQIPES LETRARE NË RMV NË RRETHANAT E DYGJUHËSISË ZYRTARE

Abstrakt

Gjuha shqipe në RMV, ashtu si dhe vetë maqedonishtja, mori një status zyrtar pas Luftës II Botërore, kur Jugosllavia u bë Republikë Socialiste Federative.

Shkollimi fillor në gjuhën shqipe, që kishte nisur më 1941 me shpërbërjen e Mbretërisë Jugosllave, vijoi edhe më tej me kufizime të njohura; shqiptarët patën një gazetë qendrore dhe botime të tjera në gjuhën shqipe. Varieteti letrar i përdorur ishte gjuha zyrtare e shtetit shqiptar të paraluftës, e mbështetur në gegërishten jugore (e ashtuquajtura elbasanishte letrare). Të folmet shqipe të Maqedonisë (që i përkasin kryesisht gegërishtes qendrore) nuk kishin arritur të prodhonin ndonjë varietet letrar të qëndrueshëm. Ecuria e mëtejshme e shqipes letrare në Maqedoni, ashtu si edhe në Kosovë, karakterizohet nga konvergjenca e brendshme dialektore, nga stabilizimi i trajtave drejtshkrimore e gramatikore mbi bazën e trajtave të përgjithshme të shqipes dhe nga afrimi hap pas hapi me varietetin letrar të shtetit amë.

Siç është bërë e njohur, që më 1967, një komision ekspertësh argumentoi se në RS të Maqedonisë ishte e përshtatshme dhe e nevojshme të adoptohej varieteti letrar mbi bazën e toskërishtes së përgjithshme, që po kristalizohej në Shqipëri. Kështu që në Maqedoni ishte arritur tashmë ajo që u vendos në Konsultën Gjuhësore të Prishtinës, në prill 1968 dhe që u sanksionua në Kongresin e Drejtshkrimit më 1972.

Sot statusi i gjuhës shqipe në RMV ka përparuar në mënyrë të ndjeshme dhe ngritja e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës Shqipe hap mundësi të reja për të vendosur një disiplinë shtetërore në përdorimin publik të gjuhës shqipe. Në rrethanat e RMV-së, mendoj se dy janë vështirësitë kryesore që duhen kapërcyer: nga njëra anë, ndikimi i të folmeve vendore (sidomos në format fonetike e gramatikore), dhe, nga ana tjetër, ndikimi i maqedonishtes, sidomos në ndërtimet sintaksore dhe formulat e ndryshme të gjuhës zyrtare burokratike, të cilat, me intensifikimin e sotshëm të marrëdhënieve të individit me institucionet publike marrin përhapje edhe në ligjërimin e përditshëm. Kolegët nga RMV-ja, po edhe të tjerë, kanë vënë në dukje herë pas here shembuj të këtyre ndikimeve, që janë bërë tashmë shprehi gjuhësore, por që gjithsesi duhen shkulur me vendosmëri nga përdorimi.

Detyra që ka marrë mbi vete AZGJ nuk duhet vështruar si një punë e brendshme e RMV, por si një sfidë për mbarë gjuhën shqipe dhe gjuhësie shqiptare. Atë detyrë duhet ta përballojmë të gjithë së bashku. Natyrisht AZGJ ka barrën kryesore, por ne të tjerët, nga Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës duhet t'i gjendemi pranë me fjalë e me vepra. Suksesi i punës së AZGJ do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë mbi ecurinë e përvetësimit e të zbatimit të shqipes letrare në Shqipëri e në Kosovë. Për këtë mendoj që puna e AZGJ të bëhet sa më e njohur, të mos kufizohet brenda një rrethi njerëzish. Do të jetë e nevojshme dhe e frytshme që në këtë veprimtari të përfshihet shkolla në të gjitha nivelet e saj (edhe shkollat e larta), duke gjetur forma të përshtatshme për

këtë (kam parasysh që të përfshihen në tekstet dhe në programet këshillime gjuhësore që do të formulojë AZGJ).

Përveç kësaj me mësuesit e gjuhës shqipe dhe të gjuhëve të huaja të organizohen ligjërata e diskutime, që do të çojnë në shtrirjen e interesimit shoqëror për kulturën e gjuhës. Mendoj se AZGJ duhet të parashikojë botimin e një organi të posaçëm të vetin, që mund të quhej "Kumtari i AZGJ" (organ tremujor me udhëzime, vendime, këshillime, konstatime, pyetje-përgjigje etj.). Krahas kësaj të përhapet më shumë në RMV revista "Gjuha shqipe" e Institutit Albanologjik të Prishtinës (mundësisht të pajtohen bibliotekat dhe shkollat), ku të shtohen bashkëpunimet nga RMV, sidomos të pasqyrohet puna e AZGJ dhe t'i bëhet jehonë asaj. AZGJ të ndikojë që çështjet gjuhësore të kenë më shumë vend në shtypin e shkruar dhe në radio dhe në televizion. Ngritja e AZGJ duhet vlerësuar si një rast i lumtur që fton të punojmë me forca të bashkuara për një të mirë të madhe kombëtare.

Rami MEMUSHAJ

STANDARDET E DYFISHTA TË DYGJUHËSISË PËR BALLKANIN

Abstrakt

Miratimi i ligjit për dygjuhësinë dhe masat për zbatimin e tij, përbëjnë dy zhvillime pozitive për shqiptarët dhe për vetë Maqedoninë e Veriut, por ato duhen parë si një program minimum, përveç që është herët për të qenë optimistë. Sepse duhet një hapësirë kohore më e gjatë për të parë efektet e zbatimit të këtij ligji.

Në gadishullin tonë kemi dy modele të politikave të dygjuhësisë që janë zbatuar vetëm për shqiptarët. Në Kosovë, serbishtja, që flitet nga 5% e popullsisë së atjeshme, është gjuhë zyrtare paralele, me të njëjtin status me shqipen. Dhe ky status atje respektohet në mënyrë rigoroze nga shteti kosovar në legjislacion, në emërimet e institucioneve dhe në çdo cep të Kosovës.

Në Maqedoninë e Veriut, ku shqiptarët përbëjnë të paktën 20% të popullsisë, shqipja është gjuhë e dytë zyrtare dhe vetëm atje ku e flasin 20% e popullsisë dhe, për më tepër, as përmendet me emër po me togun "gjuha që e flasin 20 % e popullsisë".

Faktori politik dhe intelektualët shqiptarë duhet të luftojnë, së pari, që ky ligj të zbatohet plotësisht; së dyti, që në kushtetutën e Maqedonisë së Veriut gjuha shqipe të përmendet me emër e jo me eufemizëm dhe nga ligji të hiqet togfjalëshi eufemistik; së treti, që shqipja të bëhet gjuhë zyrtare paralele, si

serbishtja në Kosovë. Ky do të ishte programi maksimum i shqiptarëve. Nuk duhet të ketë standarde të dyfishta.

Ruajtja e dy standardeve i shërben paradigmës së asimilimit të shqiptarëve që ka mbizotëruar në atë rajon prej një shekulli; që të mbijetojë e të prosperojë Maqedonia e Veriut, paradigmës së asimilimit duhet t'ia zërë vendin paradigma e bashkëjetesës së dy etnive kryesore.

Zeqirija IBRAHIMI

POLITIKAT GJUHËSORE EVROPIANE NË PËRQASJE ME POLITIKËN GJUHËSORE NË RMV

Abstrakt

Planifikimi gjuhësor është ndër çështjet themelore të politikave shtetërore. Në kuadër të këtyre politikave gjithsesi janë edhe politikat gjuhësore ose planifikimi gjuhësor. Ideja themelore e kësaj teme është që të merret me krahasimin e politikave gjuhësore në vende të ndryshme evropiane (Zvicra, Spanja, Finlanda, Belgjika), në shtete të rajonit (Kroacia, Bosnjë e Hercegovina dhe Kosova) dhe kjo të krahasohet me politikat gjuhësore në Maqedoninë e Veriut.

Hipoteza themelore është se Republika e Maqedonisë së Veriut ka qasje diskriminuese, sepse gjuhën shqipe e kategorizon si gjuhë të minoriteteve dhe, rrjedhimisht, e diskualifikon nga kategoria e gjuhës së shumicës. Kjo sigurisht ka të bëjë edhe me modelin e organizimit shtetëror, që e determinon edhe politikën gjuhësore.

Synimi i kësaj teme është të shpjegojë se Maqedonia e Veriut, si vend që aspiron për aderim në BE, duhet t'i ndjekë shembujt e mirë të politikave gjuhësore të vendeve të Bashkimit Evropian.

Veronika KAREVA

QASJA NDAJ MËSIMIT TË GJUHËS SI MOTIV PËR POPULLARIZIMIN E GJUHËS SHQIPE TE NXËNËSIT E RINJ ME GJUHË AMTARE MAQEDONASE DHE PRINDËRIT E TYRE

Abstrakt

Duket që në shoqërinë bashkëkohore, para se gjithash si rezultat i proceseve të mëdha demografike me të cilat ballafaqohemi në nivel botëror dhe globalizimi, thuajse nuk ka njeri që nuk është i vetëdijshëm për leverditë nga njohja dhe përdorimi i më shumë gjuhëve (multilingualizmi ose shumëgjuhësia). Megjithatë, në suazat e shtetit tonë sikur edhe më tej ekziston rezistencë ndaj mësimit të gjuhës shqipe nga nxënësit me gjuhë amtare maqedonase në arsimin fillor apo kjo nuk ka marrë proporcione të dëshiruara.

Qëllimi i këtij punimi është që të analizoj shkakun e këtij qëndrimi dhe çfarë mund të ndërmerret për tejkalimin e të njëjtit. Konsiderojmë që me një qasje të duhur metodologjike, sipas programit mësimor dhe materialeve të bëra sipas atyre që përdoren për mësimin e gjuhës angleze, si dhe përmes promovimit të qasjes së këtillë tek prindërit e rinj, dukshëm do të kontribuohet në popullarizimin e mësimit të gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut tek nxënësit në arsimin fillor të cilët nuk e kanë maqedonishten gjuhës amtare. Kjo më tej do të ketë rol në afrimin dhe integrimin e pjesëtarëve të të dy komuniteteve, sepse gjuha lidhet ngushtë me kulturën, traditën dhe mënyrën e jetesës. Pjesëmarrës në hulumtim janë njëzet e

pesë (25) prindër të fëmijëve nga arsimi fillor, një drejtor i shkollës fillore dhe tre profesorë të gjuhës shqipe.

Pritet që rekomandimet e marra në bazë të përfundimeve të këtij hulumtimi të shfrytëzohen për institucionet e shtetit që i krijojnë programet dhe planet arsimore, për prindërit dhe për të gjithë ata që profesionalisht merrem me mësim gjuhësor.

Fjalët kyç: *gjuha angleze, mësimi, arsimi fillor, shumëgjuhësia.*

Dimitar PANDEV

TEORIA E SHUMËGJUHËSISË NË LINGUISTIKËN E MAQEDONISË

(me theks të veçantë të hulumtimeve linguistike të Olivera Jashar- Nastevës)

Abstrakt

Shumëgjuhësia (në formë dhe/ose të dukurisë të dygjuhësisë dhe diglosisë) është një nga opsesionet kyç të linguistikës maqedonase mes viteve të 60-ta dhe 80-ta të shekullit XX. Njëkohësisht, kjo është edhe sfidë kyç në linguistikën botërore e cila pikërisht mbi Maqedoninë kishte vendosur këto tema në linguistikën e gjysmës së parë të shekullit XX (Vajgand, Selishçev, Sandfeld) e më vonë edhe mbi zona tjera shumëgjuhësore.

Në këtë referat, kryesisht ndiqen, por edhe aktualizohen studimet e përbashkëta të veçorive të dygjuhësisë maqedonase-shqiptare, të Bllazhe Koneskit, Bozho Vidoeskit dhe Olivera Jashar- Nastevës, me theks të veçantë të studimeve të Olivera Jashar- Nastevës në këtë sferë.

Fjalët kyç: shumëgjuhësi, dygjuhësi, diglosi, huazime, përkthim fjalë për fjalë

Klara KRANEBITTER

PUNA E TERMINOLOGJISË NË TIROLIN E JUGUT, ITALI DHE SISTEMI I INFORMACIONIT PËR TERMINOLOGJINË JURIDIKE BISTRO

Abstrakt

Në Tirolin e Jugut, i cili shtrihet në Italinë Veriore pranë kufirit austriak, popullata flet tre gjuhë kryesore: italisht, gjermanisht dhe gjuha e vogël romake ladin. Të dyja, gjermanishtja dhe gjuha ladino njihen gjuhë të pakicave në Itali me gjermanishten që janë gjuhë bashkë-zyrtare në Tirolin e Jugut. Autoritetet publike lokale duhet të përdorin italisht dhe / ose gjermanisht në tekstet dhe marrëdhëniet e tyre me qytetarët në Tirolin e Jugut; në bashkitë ladino, autoritetet gjithashtu duhet të përdorin gjuhën ladino. Kjo solli nevojën për të përpunuar terminologjitë ligjore gjermane dhe ladino për të shprehur konceptet juridike italiane.

Për shkak të afërsisë së saj gjeografike me Austrinë, Zvicrën dhe Gjermaninë, përpjekjet e zhvillimit të terminologjisë në Tirolin e Jugut së bashku me promovimin e qëndrueshmërisë së terminologjisë në gjermanishten tirolike të Jugut gjithashtu përpiqen të shmangin një rajonalizim të tepruar, në mënyrë që të nxisin komunikimin me sistemet fqinje juridike gjermanofolës.

Që nga viti 2002, puna terminologjike e bërë në të tri gjuhët është lirisht e arritshme në Sistemin e Informacionit në internet për terminologjinë juridike bistro (http://bistro.eurac.edu) zhvilluar nga Eurac Research). u rivendos plotësisht, duke shtuar karakteristika të reja në vitin 2016. Që nga

fillimi, bistro synonte të mbështeste përdorimin e saktë të terminologjisë në sektorin juridik në italisht, gjermanisht dhe ladenisht dhe të lehtësonte komunikimin midis njerëzve nga sisteme të ndryshme juridike ku përdoren këto gjuhë. Ky synim ndiqet duke botuar një koleksion të shënimeve terminologjike për këto tri gjuhë, ku pjesa gjermane konsideron edhe sisteme të tjera juridike (Austri, Gjermani, Zvicër, Bashkimi Evropian dhe e drejta ndërkombëtare) dhe kryesisht bazohet në metodën e krahasimit juridik.

Krahas hyrjeve terminologjike, të cilave mund të arrihen nga mënyra e thjeshtë ose e avancuar e kërkimit, bistro gjithashtu ofron një kërkim në listat e termave të standardizuara të publikuara nga Komisioni i Terminologjisë së Tirolit Jugor ndërmjet 1994 dhe 2012. Bistro është bërë një mjet i vlerësuar për shpërndarjen e terminologjisë juridike në Tirolin e Jugut për dy gjuhët e pakicave lokale dhe një mbështetje në rritje për komunikimin midis sistemeve të ndryshme ligjore. Stoku i të dhënave përfshin fusha të ndryshme të ligjit dhe është rafinuar dhe azhurnuar vazhdimisht. E gjithë kjo e bën bistron gjithashtu një mjet të dukshëm për rajone të tjera me situata të krahasueshme, për të cilat mund të përfaqësojë një model.

Anila OMARI

PËRKTHIMI SI FAKTOR NDIKIMI NË ZHVILLIMIN GJUHËSOR DHE PASOJAT E PËRKTHIMIT NË SHQIPEN E RMV- së

Abstrakt

Si shumica e gjuhëve me traditë të re shkrimore, edhe gjuha shqipe e ka filluar traditën e vet letrare nëpërmjet përkthimit. Shkrimet e para shqipe kanë qenë përkthime dhe përmes tyre gjuha shqipe mori tiparet e një gjuhe letrare. Edhe në kohët e mëvonshme, veçanërisht në periudhën e Rilindjes, shqipja erdhi duke u formësuar si gjuhë letrare edhe nëpërmjet përkthimeve nga gjuhët e tjera. Në ngritjen e nivelit të përpunimit të shqipes së shkruar, në pasurimin dhe intelektualizimin e saj në qindvjeçarin e fundit kanë ndikuar në një masë të madhe përkthimet. Në kontekstin e sotëm të globalizimit ekonomik dhe të kozmopolitizmit kulturor, prodhimi letrar e joletrar me të cilin ushqehet publiku ynë përbëhet në shumicën e vet nga përkthimet.

Përkthimi ndikon në mënyrë të dyanshme në gjuhë: nga njëra anë e pasuron gjuhën me mjete të reja shprehëse, nga ana tjetër mund të ndikojë në rënien në harresë të shprehjeve e ndërtimeve karakteristike vendase dhe zëvendësimin e tyre me përdorime të huaja.

Në këtë aspekt, shqipja e RMV-së është më e ekspozuar ndaj këtyre ndryshimeve në përkthimet nga gjuha shumicë e vendit si gjuhë zyrtare e shtetit dhe e shkollës, meqenëse kësaj i mbivendoset edhe bilinguizmi i përdoruesve me shqipen gjuhë amtare. Kjo sjell dhe depërtimin e strukturave të huaja në gjuhën

e mbërritjes (shqipen). Prandaj, në rrethanat e krijimit të Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës në RMV, ku një rol të rëndësishëm në veprimtarinë e saj mendohet se do të zënë përkthimet, kërkohet një vëmendje e shtuar për rritjen e cilësisë së përkthimeve dhe punësimin e përkthyesve me përvojë.

Fjalët kyç: *gjuha, gjuha letrare, përkthimi, gjuha shqipe, bilingualizmi*

Brikena KADZADEJ

Edlira BUSHATI

SHPREHJET FRAZEOLOGJIKE, TRANSFERE NDËRKULTURORE SHQIP-GJERMANISHT, GJERMANISHT-SHQIP

Abstrakt

Në mënyrë që të kuptojmë dhe të kuptohemi, duhet të gjendet një gjuhë e përbashkët me bashkëbiseduesin. Në botën e sotme shumëgjuhëshe me gjithë globalizmin, kjo gjë nuk është gjithmonë e mundur nëse nuk e zotërojmë gjuhën e tjetrit. Pikërisht këtu duhet përkthyesi / interpretuesi, i cili është lidhja, ura midis gjuhëve dhe botëve. Ai përkthen jo vetëm fjalën, gjuhën, por botën e autorit / folësit dhe të adresuesit.

Duke u nisur nga ky rol bazik i përkthimit dhe interpretimit si urë lidhëse e dy kulturave, do të përpiqemi që në këtë punim të japim një vështrim të përgjithshëm për mundësitë që ka përkthyesi/interpretuesi në procesin e përkthimit, në transmetimin e shprehjeve frazeologjike dhe fjalëve të urta, si edhe vështirësitë, problemet që mund të hasi në këtë proces.

Në rastin e shprehjeve frazeologjike dhe të fjalëve të urta, fjalë të veçanta e humbasin pak a shumë kuptimin e tyre brenda shprehjes dhe krijojnë një kuptim të ri, të përgjithshëm brenda saj.

Për këtë punim ne u konsultuam veçanërisht me literaturën nga shkenca e gjuhësisë, në veçanti me atë të komunikimit ndërkulturor, përkthimit, interpretimit etj.

Vend të rëndësishëm në përfundimet e këtij hulumtimi zë shkëmbimi profesional me kolegët përkthyes, si edhe përvoja personale.

Pa dyshim që kjo sfidë do ta shoqërojë në të ardhmen çdo përkthim dhe çdo përkthyes.

Fjalët kyç: *kuptimi, gjuha, përkthimi, interpretimi*

Asllan HAMITI

REDAKTIMI PROFESIONAL DHE GJUHËSOR I PËRKTHIMEVE

Abstrakt

Dihet se procesi i përkthimit të tekstit, të redaktimit profesional dhe gjuhësor është punë intelektuale e vështirë dhe me përgjegjësi. Ky art i krijimit të tekstit në gjuhën e synuar (B) nga gjuha e burimit (A) kalon nëpër tri faza kryesore: a) përkthimin, b) redaktimin profesional dhe c) redaktimin gjuhësor.

Redaktimi ashtu si edhe përkthimi është art më vete. Këtë veprimtari duhet ta bëjnë njerëzit profesionistë me bashkërendimin e punëve individuale ose punës në grup. Në këtë kumtesë, duke u mbështetur edhe në përvojën personale, do të shtjellojmë punën serioze e me përkushtim që duhet të bëjnë jo vetëm përkthyesi, por edhe redaktori profesional e ai gjuhësor. Prodhimi përfundimtar do të jetë cilësor nëse përkthimi do të kalojë nëpër të gjitha fazat e përkthimit.

Jo vetëm teksti i përkthyer, por edhe shkrimet origjinale në gjuhë amtare duhet rilexuar, ndrequr e përmirësuar ta sjellë në formën përfundimtare. Shumëkush mendojnë gabimisht se shkrimtarët apo përkthyesit janë njerëz që kanë prirje të madhe për të shkruar, prandaj nuk hasin në kurrfarë vështirësish gjatë hartimit a përkthimit të veprave. Mirëpo, ata që kanë pasur mundësi të gjurmojnë punën krijuese të shkrimtarëve, flasin ndryshe. Për kujdesin dhe mundin e tyre dëshmojnë shënimet e

shumta që na kanë lënë shkrimtarët dhe versionet e shumta të veprave, deri në formën përfundimtare të tyre.

Shumica e shkrimtarëve kanë mbajtur shënime në fletore të veçanta, duke regjistruar me kujdes fjalë e fraza të ndryshme, të cilat i kanë dëgjuar në popull ose i kanë gjetur të shkruara nëpër libra, revista, gazeta etj., që dëshmojnë zellin e tyre në lëvrimin e gjuhës. Kështu, siç dihet, Maksim Gorki nuk e kishte dorëzuar një tregim në shtyp në kohën e paraparë derisa iu kujtua një fjalë e nevojshme që assesi nuk i kujtohej. Floberi shkruan se "po mbushet gati një muaj qyshkur po përpiqem të gjej katër fraza të shkreta që po më nevojiten."

Balzaku në një letër pohon se "secilën faqe e kam shkruar nga 50 deri më 60 herë. Nuk ka asnjë tabak shtypi ndër veprat e mia, që të mos e kam korrigjuar nga 17, 18 apo 19 herë". Gogoli, duke folur për punën e vet krijuese, shprehet se "së pari duhet të hedhen në letër që të gjitha, ashtu siç i bien ndërmend njeriut, qoftë edhe keq, turbull dhe duhet harruar ajo fletore. Pas një a dy muajsh, herë-herë edhe më tepër lipset të merret dhe të lexohet ajo që është shkruar: Do të shihni se shumë sende nuk qëndrojnë ashtu, se ka shumë gjëra të tepërta, e që aty-këtu mungon diçka. Bëni korrigjimet dhe vërejtjet në margjinë dhe përsëri lëreni fletoren. Pas një kohe, këtë version kopjojeni me dorën tuaj. Gjatë kësaj pune vetvetiu do të lindin mendime të reja, shkurtime, shtesa, pastrimi i stilit, ndërmjet fjalëve të mëparshme do të lindin fjalë të reja, të cilat e kanë vendin aty medoemos, por që, nuk e di pse, nuk shfaqen menjëherë... "

Ismail HAMITI

PËRKTHIMI I LIRË DHE PËRKTHIMI I FJALËPËRFJALSHËM

Abstrakt

Çështja e lirisë së përkthyesit gjatë procesit të përkthimit, apo thënë ndryshe, pyetja se deri ku shtrihen këta kufij gjatë përkthimit kanë zgjuar debate të shumta nga studiues të shumtë, që nga koha antike e deri në ditët e sotme.

Aq më tepër, gjithsecili që merret me përkthim, qoftë si aktivitet plotësues apo si profesion, përballet me këtë pyetje para çdo teksti që e ka si objekt përkthimi. Mendimet e tyre për këtë çështje thelbësore kanë shprehur autorë të ndryshëm, duke filluar që nga Ciceroni, Shën Jeronimi, Etien Dolet, Martin Luteri etj.

Çështja paraqitet edhe më e vështirë kur kemi të bëjmë me përkthimin e elementeve kulturore, të cilat mungojnë në gjuhën e synuar. Prandaj, në fund do të jepen disa mundësi apo opsione që i ka në dispozicion përkthyesi për t'u dalë mbanë këtyre vështirësive.

Veç kësaj, këtu trajtohen edhe disa çështje që prekin kufijtë e përkthyeshmërisë, për të cilat shumë studiues të përkthimit pohojnë se janë të papërkthyeshme, siç janë: proverbat, idiomat, shprehjet frazeologjike dhe të ashtuquajturat lojë fjalësh.

Fjalët kyç: *përkthim i lirë, përkthim i fjalëpërfjalshëm, Ciceroni, Shën Jeronimi, vështirësitë gjatë përkthimit të elementeve të kulturës, hapat e mundshëm për përkthimin e elementeve të dallueshme kulturore.*

Adnan JASHARI

ASPEKTI JURIDIKO-NORMATIV I PËRDORIMIT TË GJUHËVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Abstrakt

Përdorimi i gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut në aspektin juridiko –normativ, përpos me dispozita kushtetuese, rregullohet edhe me dispozita ligjore. Rregullimi normative ligjor ka shkaktuar qëndrime te ndryshme edhe atë jo vetëm politike por edhe juridike.

Si rezultat i interesit dhe qëndrimeve diametralisht të kundërta në opinionin publik, në këtë punim do trajtojë në aspektin juridiko - normativ si kushtetues ashtu edhe ligjor përdorimin e gjuhëve, duke bërë krahasim midis trajtimit kushtetues dhe trajtimit ligjor, gjithnjë duke bërë dallim dhe paralele ne veçanti midis gjuhës maqedonase dhe gjuhës shqipe.

Fokusi është përcaktimi i kornizës së përdorimit të gjuhëve jo vetëm në aspektin material por edhe në aspektin procedural. Normalisht, varësisht nga nevoja në punim do të trajtojmë edhe aspektin krahasues dhe historik, duke bërë kështu krahasime midis përdorimit të gjuhëve në disa shtete në rajon siç është rasti me përdorimin e gjuhëve në Republikën e Kosovës.

Mimoza KORE

LIGJI PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE NË RMV DHE SFIDAT E STATUSIT TË SHQIPES NË KËTË KONTEKST

Abstrakt

Në këtë kumtesë do të trajtojmë realitetin e ri gjuhësor, që u krijua për shqipen në RMV me miratimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve. Maqedonia e Veriut është një vend multietnik dhe pakica me mbi 20% fitoi me këtë Ligj të drejtën e gjuhës së dytë zyrtare. Bilinguizmi duhet parë si vlerë për shoqërinë e këtij vendi, sepse prodhon stimuj origjinalë të ndërthurjeve kulturore, të njohjes më të mirë të etnive me njëra-tjetrën.

Më tej do të ndalemi te statusi i shqipes si gjuhë e dytë zyrtare, i cili kërkon rritje të kujdesit për zbatimin drejt të saj, shton përgjegjësinë e të gjithë atyre që kanë për detyrë ruajtjen dhe përkujdesjen e vazhdueshme. Në këtë aspekt do të paraqesim shkurtimisht disa shkelje të normës së shqipes standarde si dhe probleme që lindin gjatë përkthimit nga njëra gjuhë te tjetra, të cilat kërkojnë njohuri të mira të gjuhës burimore ashtu dhe të gjuhës në të cilën përkthehet.

Fjalët kyç: të drejtat dhe liritë e njeriut, bilinguizmi, gjuhë shqipe, huazime, shqipe standarde

Jusuf ZEJNELI

KONFERENCË SHKENCORE NDËRKOMBËTARE TEMA: "SHUMËGJUHËSIA DHE SFIDAT E ZBATIMIT TË LIGJIT TË GJUHËS NË RMV"

Abstrakt

Sfidat e zbatimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Çështja e përcaktimit të gjuhëve zyrtare, dallon në shtete të ndryshme, sikurse nga baza juridiko-kushtetuese gjithashtu edhe në praktikat e zbatimit të tyre. Secili shtet cilësohet me veçori të trajtës së sundimit, organizimit të pushtetit shtetëror, organizimit të administratës shtetërore-publike dhe praktikave të zbatimit të ligjeve. Sidomos, rëndësi ka funksionimi i sistemit juridik në shtetet multietnike, në të cilat vinë në shprehje diversiteti gjuhësor, etnik dhe të ngjashme.

Bota njeh grupe të ndryshme etnike dhe gjuhësore, në shtetet përkatëse dhe ky realitet kërkon që të gjithë të jenë të barabartë para ligjit dhe njëkohësisht të gëzojnë të drejtat e tyre. Diversiteti nuk duhet shërbej si pengesë e zhvillimit të shteteve, përkundrazi ai duhet kuptuar si vlerë dhe mundësi e respektimit të të gjithëve dhe zhvillimit të gjithanshëm shoqëror. Rëndësi duhet kushtuar të drejtave të tyre kryesisht në sferën e përdorimit të gjuhës, simboleve kombëtare, kulturës, përfaqësimit të drejt dhe vendimmarrjes në kuadër të institucioneve të sistemit juridik-politik në shtetet përkatëse.

Edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut hasen praktika të ndryshme të bazës juridike dhe zbatimit praktik të akteve juridike të cilat rregullojnë përdorimin e gjuhëve zyrtare, në periudha të ndryshme kohore. Ajo që kërkon vëmendje, është fakti se shpeshherë hasen dallime mes asaj që përcakton norma

juridike dhe realitet faktik, në kuadër të zbatimit të tyre. Andaj qëllimi ynë, është të shtjellojmë sikurse bazën juridike njëkohësisht edhe sfidat e zbatimit praktikë të Ligjit të gjuhëve në vend.

Edhe pse zhvillohen përpjekje për të forcuar këtë sferë, përsëri hasen vështirësi të theksuara, të cilat më së shumti reflektohen edhe në organet e administratës shtetërore-publike, të cilat duhet të respektojnë ligjet në fuqi, në mënyrë që secili qytetar të jetë i barabartë para ligjit. Krahas forcimit të bazës juridiko-kushtetuese, në veçanti në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kërkohet edhe trajnimi, modernizimi dhe ngritja e vetëdijes së tërësishme për zbatimin e ligjeve.

Fjalët kyç: *Gjuhët zyrtare, baza juridiko-kushtetuese, shtetet multietnike, sfidat e zbatimit praktik, Ligji për përdorimin e gjuhëve, administrata shtetërore-publike.*

Qemal MURATI

ÇËSHTJA E GJUHËS AMTARE - BOSHTI RRETH SË CILIT SILLEN TË GJITHA TË DREJTAT E TJERA

Abstrakt

Tematika e Konferencës shkencore *"Shumëgjuhësia dhe sfidat e zbatimit të ligjit të përdorimit të gjuhëve në RMV",* organizuar nga Agjencia për Zbatimin e Gjuhës Shqipe, në Shkup (21-23 shkurt 2020), në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare, është një rast i mirë për të nxitur reflektimet tona për gjuhën amtare dhe për mosurrejtjen e gjuhës së tjetrit. Kjo, sepse gjuha nuk është vetëm mjeti themelor i komunikimit, por gjuha të jep edhe identitet, andaj konsiderohet monumenti më unik dhe më përfaqësues i popullit që e flet, që dikush e ka quajtur gjuhën metaforikisht edhe pagodë (faltore) e partenon.

Klod Levi Strausi (Claude Lévi- Strauss) – një nga intelektualët më të rëndësishëm të kulturës evropiane të kohës sonë dhe themeluesi i strukturalizmit, thekson se "*Gjuha është mënyra e parë për të vendosur rendin në botë*". Pa gjuhë ose, më drejt, pa barazi gjuhësore do të kishim të kundërtën e rendit të gjërave, konflikte dhe kaos në shoqëritë shumëgjuhëshe - siç edhe ka pasur jo rrallë edhe në këto hapësira. Ngaqë "*Ai që është në gjendje të ndalojë gjuhën, është në gjendje të ndalojë jetën*" - thotë Ovidi Montllor.

"*Çështja e gjuhës amtare është mbase çështje thelbësore, sepse përbën boshtin rreth së cilit sillen dhe të gjitha të drejtat e tjera – nga përdorimi i medieve, te veprimtaritë kulturore, e deri te arsimi*" (Bela Ajzenberg).

Gjuhët në thelbin e vet janë pika takimi dhe ura komunikimi, që i bashkojnë njerëzit e nuk i ndajnë. Por në Ballkan dhe në Maqedoninë e Veriut gjuhët akoma shihen edhe me një mentalitet tjetër degradues, sidomos gjuha e tjetrit.

Në këtë vështrim, do të fokusohemi për gjuhën shqipe si pasurinë tonë më të madhe kombëtare - por dhe si vlerë evropiane dhe si vlerë botërore, nga dy perspektiva:

1) nga perspektiva e zyrtarizimit të shqipes në RMV, dhe

2) nga perspektiva e kujdesit në përdorimet e sotme publike.

Vebi BEXHETI

RRETH DILEMAVE TË ZBATIMIT TË DREJTË TË LIGJIT PËR GJUHËN SHQIPE

Abstrakt

Në këtë kumtesë shtrohet dilema për zbatimin e drejtë dhe në kohën e paraparë sipas Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, përmes të cilit vetëm nënkuptohet gjuha shqipe, e assesi t'i përmendet emri i vërtetë. Në pjesën hyrëse të punimit, përmes një historiku të shkurtër përshkruhet rruga e vështirë dhe e mundimshme e zhvillimeve që kishin të bëjnë me kërkesën e shqiptarëve për përdorimin e gjuhës së tyre në shtetin e përbashkët.

Në këtë pjesë përmendet edhe Kushtetuta e vitit 1974 e Jugosllavisë socialiste, me të cilën Gjuha shqipe e fitoi të drejtën e gjuhës zyrtare, si e barabartë me maqedonishten, pa u shndërruar në përqindje, edhe pse ajo që u garantua me këtë Kushtetutë, nuk u realizua për shkak të politikës diskriminuese të shtetit jugosllav dhe Republikës së saj socialiste të Maqedonisë. Në pjesën historike të këtyre zhvillimeve që kishin të bëjnë me Gjuhën shqipe, përmendet edhe dështimi i radhës i këtyre kërkesave të shqiptarëve, që doli nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit.

Edhe pse në këtë Konferencë që punimet i zhvilloi nën mbikëqyrjen e ndërkombëtarëve, që do shërbente si garantë për të drejtat e shqiptarëve, përfshirë edhe përdorimin zyrtar të shqipes në të gjitha nivelet e shtetit si të barabartë me atë maqedonase, kjo gjuhë, jo që nuk u zyrtarizua, por e pësoi goditjen më të rëndë, duke u shndërruar në përqindje. Kur i kemi parasysh këto ngecje

të përdorimit të Gjuhës shqipe, qysh nga Marrëveshja e Ohrit dhe dy ligjet e mëvonshme që assesi ta përmirësojnë statusin e kësaj gjuhe, përkundrazi vetëm sa e ngulfatnin brenda kornizave të përqindjes, me të drejtë shtrohet dilema nëse do zbatohet në mënyrë të plotë dhe të drejtë edhe Ligji i fundit për Përdorimin e Gjuhëve.

Dilema se a do të realizohet ajo që është shkruar, kur edhe më tutje Gjuha shqipe përmendet si përqindje, sa vjen e shtohet. Për gjithë këtë ngecje, pavarësisht një përparimi të theksuar të Ligjit në fuqi, krahasuar me tendencat e mëparshme, për fat të keq, përcaktuese e statusit të Gjuhës shqipe edhe më tutje mbetet disponimi politik i partive maqedonase, që vazhdimisht i ndërrojnë qëndrimet për nivelin e përdorimit të kësaj gjuhe, varësisht se prej nga veprojnë, nga pozita apo opozita.

Në punim bëhet fjalë edhe për qëndrimin e partive shqiptare, për këmbënguljen e tyre dhe dinjitetin kombëtar që duhet ta kenë, në mbrojtje të gjuhës së votuesve të tyre, me votën e të cilëve kaq vite qëndrojnë në pozita pushtetare. Punimi mbyllet me konstatimin se, arritja e përdorimit të Gjuhës shqipe si e barabartë dhe zyrtare, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, do arrihet vetëm atëherë, kur statusi i dëshiruar i kësaj gjuhe për shqiptarët, të bëhet kategori kushtetuese.

Fjalët kyç: gjuhë, barazi, marrëveshje, ligj, politikë

Josipa RIZANKOSKA, Jasmina TRAJKOSKA - NAUMOSKA

SFIDAT E ZBATIMIT TË LIGJIT PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Abstrakt

Krijimi i politikave efikase publike është një sfidë e madhe në demokracitë hibride, të cilat përballen me mungesë në përdorimin e mekanizmave politikë të krijuar në bazë të analizave dhe dëshmive. Vlerësimi i ndikimit të rregullativës është metodologjia, e cila është e pranuar në përmasa të gjera si instrument efikas gjatë krijimit të politikave publike, për të cilat zbatimi nuk do të jetë i pasigurt. Me vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në vitin 2009, metodologjia e vlerësimit të ndikimit të rregullativës bëhet e obligueshme gjatë krijimit të rregullativave (politikave publike). Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (2018) është politikë publike, e cila zbatohet pa i tejkaluar fazat e nevojshme të parapara në vlerësimin e ndikimit të rregullativës.

Si rezultat i mënyrës së sjelljes së rregullativës (politikës publike) pa u bazuar në analiza dhe dëshmi, institucionet përballen me një sërë paqartësish në zbatimin e saj, që do të thotë se bëhet fjalë për politikë joefikase publike. Në këtë punim analizohet mënyra e krijimi të politikave publike gjuhësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ligji për Përdorimin e Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale nga viti 2008, si dhe hapat e sjelljes së Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve (2018) mbi punën e institucioneve shtetërore dhe ndërmarrjeve publike me ç'rast fitojmë pasqyrë konkrete për sfidat kryesore, me të cilat përballen institucionet në kuadër të sistemit politik në RMV për zbatimin e kësaj rregullative.

Shaban SINANI

PËR NJË RREGULLIM LIGJOR TË PËRDORIMIT TË SHQIPES SË NJËSUAR NË FUNKSIONE PUBLIKE

Përgjegjësia për një rregullim ligjor të përdorimit të shqipes në funksione zyrtare dhe publike buron nga: 1. Roli i gjuhës shqipe si faktori më njësues në identitetin kombëtar të përdoruesve të saj; 2. Shumëfishimi i mënyrave të funksionimit të saj në kushtet e shoqërive të hapura dhe të teknologjive të reja të ndërkomunikimit; 3. Dukuritë dhe raportet e reja midis identitetit gjuhësor, identitetit kombëtar dhe identitetit shtetëror të folësve të shqipes.

Me probleme të ngjashme janë përballur edhe gjuhë të tjera: gjermanishtja flitet në tre shtete, greqishtja në dy shtete, frëngjishtja në tre shtete.

Deri më sot, e vetmja marrëveshje njësuese për shqipen e njësuar është ajo e Kongresit të Drejtshkrimit (1972). Në shoqëritë e kontrolluara në të cilat kanë jetuar shqiptarët deri tri dekada më parë rregullat e drejtshkrimit ishin të pranuara vullnetarisht dhe kjo mjaftonte. Por në një kohë të mëvonshme *vullnetarizmi është provuar si i pamjaftueshëm*. Prandaj ka dalë e nevojshme që statusi i shqipes në funksionet zyrtare e publike të rregullohet me ligj.

Për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë ky është një detyrim që buron nga Kushtetuta, në nenin 14 të së cilës janë përkufizuar *të gjitha shenjat që kanë lidhje me identitetin kombëtar dhe shtetëror*: *gjuha zyrtare dhe simbolet kombëtare* (himni, flamuri, stema).

E vetmja përbërëse e parregulluar me ligj është gjuha. Një projektligj për gjuhën shqipe u është propozuar ligjvënësve në vitin 2005. Në periudhën e mëvonshme janë bërë përpjekje për zgjidhje të pjesshme të problemit, me akte nënligjore. Në kushtet e reja ligjore që ekzistojnë në Akademinë e Shkencave është mundësuar rimarrja e nismës juridike për një ligj për përdorimin e shqipes në funksione publike e zyrtare.

Ky ligj do të bëjë dallimin për gjuhën shqipe si një prej trashëgimive themelore të shqiptarëve prej shekullit të kapërcyellit deri më sot (shek. VII-XXI); do të përkufizojë stilet dhe regjistrat e ligjërimit zyrtar e publik; do të vlerësojë si pasuri të pazëvendësueshme dialektet, nëndialektet dhe të folmet shqip kudo që ajo përdoret, duke përfshirë arbërishten dhe të folmet e arvanitasve; do të sigurojë mbrojtjen e higjienës gjuhësore; do të riafirmojë njësinë e shqipes së shkruar duke bërë dallimin midis drejtshkrimit dhe drejtshqiptimit, do të përcaktojë stimujt dhe ndëshkimet për folësit model dhe për folësit që në mënyrë të qëllimshme dhe të vetëdijshme cenojnë rendin e saj në komunikim.

Një ligj për përdorimin e njësuar të shqipes nuk pengon që dijetarët të vijojnë punën e tyre për përsosjen e normës, për hapjen e saj ndaj përdoruesve, po aq sa dhe për prestigjin e tyre gjuhësor, për njësinë e kështilluar, për zhvillimin e shqipes si një organizëm i gjallë.

Haki YMERI

SHQIPJA E MAQEDONISË SË VERIUT- GJUHË E NJËZETPËRQINDSHIT???

Abstrakt

Në këtë kumtesë do të bëhet fjalë shkurt:

1. Për gjuhën e popullit, atë të panormuarën në mënyrë institucionale, të cilën e "kodifikoi" njeriu – gjeni, pjesëtar i rëndomtë i popullit, që në fillet e saj paraqiste si një "të folur" të një grupi më të madh njerëzish, që jetonin dhe vepronin në një territor të padefinuar mirë.....

2. Për fillet e hershme të këtij veprimi njerëzor që filluan shumë herët, atëherë kur njeriu pati nevojë, për herë të parë, t`i shprehë mendimet dhe ndjenjat e veta, e pastaj edhe për t`i këmbyer ato me të tjerët që jetonin dhe punonin pranë tij. Të folurit e tij filloi të ndërtohet, edhe më shpejt, kur njeriu duhej të kryente punë më të rënda, të cilat nuk mund t'i kryente vetëm pa ndihmën e pjesëtarëve të tjerë në bashkësi.

3. Për krijimin e një sistemi gjuhësor specifik që dallon nga një sistem i një bashkësie tjetër që jeton dhe punon pranë ose më larg tij.

4. Për shumë peripeci të saj në kohën e monizmit, kohën e Jugosllavisë titiste, ku populli pa pak dritë. Në këtë hapësirë të gjithë popujt, në një farë mënyre, ishin të diskriminuar, mirëpo, shkalla e diskriminimit nuk ishte e njëjtë për të gjithë që jetonin në Jugosllavinë e atëhershme.

5. Shkalla e diskriminimit të shqipes në trojet Jugosllave nuk ishte e njëjtë. Shqiptarët e Republikës së Maqedonisë, në

aspekt të përdorimit të gjuhës amtare ishin më të diskriminuarit.

6. Për pritjen e kotë të realizimit të disa të drejtave gjatë viteve 90, në kohën e të ashtuquajturës demokraci në vend të avancimit të drejtave edhe për shqiptarët, ata hasën në një avaz të vjetër.

7. Për Ratifikimin e Kartës Evropiane për Përdorimin e Gjuhëve Rajonale apo Minoritare, që e propozoi Qeveria.

8. Për rritjen e tensioneve dhe sjellja e një konflikti më të çuditshëm në historinë e konflikteve me palë ndërluftuese edhe deputetë të partive kundërshtare në një Parlament të përbashkët.

9. Për përcaktorin NJËZETPËRQINDËSH për shqipen.....

10. Për metodën e përcaktimit të përqindjes së gjuhës së qytetit tim të lindjes.

Demush BAJRAMI

Emin AZEMI

MAQEDONIA E VERIUT DHE SFIDAT E SHTRIRJES SË PËRDORIMIT ZYRTAR TË GJUHËS SHQIPE

Abstrakt

Shikuar në rrafshin sociologjik, gjuha në gjithë këtë varësi në mes të memories kolektive dhe komunikimeve të brendshme e të jashtme, paraqet hallkën më të rëndësishme që e përforcon një identitet të caktuar etno-psikologjik.

Shtetet që aspirojnë për t'u integruar në Bashkimin Evropian (BE), duhet t'i standardizojnë ligjet nacionale me legjislativën evropiane. Për rrjedhojë, diversiteti gjuhësor dhe kulturor është mishëruar në Kartën Evropiane të të Drejtave themelore të miratuar nga liderët e BE-së në vitin 2000. Ajo nuk mbulon vetëm 24 gjuhët zyrtare të Unionit, por edhe shumë gjuhë regjionale dhe të pakicave që fliten në segmente të popullsisë së saj. Ka ende raste në rajon, ku ka një refuzim ndaj shumëgjuhësisë, kurse diku as gjuha e pakicave nuk është zyrtarizuar.

Ky punim nxjerr në pah përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut, i formuluar si 'gjuhë të cilën e flasin mbi 20 për qind nga numri i përgjithshëm i popullatës'. Ekspertët shqiptarë nuk janë pajtuar me këtë formulim, për arsye se si i tillë nuk e adreson drejt atributin që duhet ta ketë një gjuhë kombëtare në raport me folësit e saj. Dykuptimësia e këtij formulimi mund të nxisë interpretime të ndryshme dhe me

kalimin e kohës ka rrezik që të zbehet edhe rëndësia e këtij ligji që rregullon përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe. në shumë institucione e drejtori shtetërore, Ligjit për përdorimin e gjuhës shqipe po i bëhet obstruksion gjatë zbatimit praktik. Gjatë komunikimit me shkrim midis këtyre institucioneve e drejtorive, por jo vetëm edhe në komunikimet tjera bëhet shkelje flagrante e ligjit për përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe, për arsye se dokumentet nënshkruhen nga krerët e institucioneve vetëm se në një gjuhë.

***Fjalët kyç**: Gjuha shqipe, shumëgjuhësia, komunikimi, identiteti, Maqedonia e Veriut, BE, ligji.*

Sejdi GASHI

PLANIFIKIMI GJUHËSOR DHE STATUSI I GJUHËVE ZYRTARE NË KOSOVË GJATË VITEVE 1999-2009

Abstrakt

Çështja e planifikimit gjuhësor, zgjedhjes së variantit për ngritje në normë standarde, përcaktimi i statusit zyrtar të gjuhëve përkatëse në vende të caktuara, prej kohësh ka qenë shqetësim, por njëkohësisht edhe orientim i studimeve të gjuhëtarëve të ndryshëm.

Ne në këtë punim do të përpiqemi që ta trajtojmë procesin e planifikimit gjuhësor dhe të statusit zyrtar të gjuhëve në Kosovë gjatë viteve 1999-2009. Në këtë kuadër nuk synojmë që ta shterojmë së trajtuari problemin në fjalë, por do të përpiqemi që t'i paraqesim dhe t'i kundrojmë disa çështje dhe probleme nëpër të cilat kanë kaluar gjuhët në Kosovë.

Tematika e tillë është interesante dhe si e tillë paraqet interes të madh për studime të mëtejmë në fushën e sociolinguistikës në përgjithësi e në atë të shqipes në veçanti. Duke qenë kështu, këto procese gjuhësore janë analizuar dhe studiuar nga studiues shqiptarë dhe të huaj siç janë Rexhep Ismajli, Victor A. Friedman, Shkumbin Munishi, Bahri Beci, Gjovalin Shkurtaj, Joshua A. Fishman, Tomor Osmani, Majlinda Bregasi dhe studiues të tjerë , të cilët në vështrimet dhe vlerësimet e tyre kanë korrur rezultate dhe kështu kanë krijuar mundësi, veçmas te studiuesit e rinj, që këto studime të kenë mundësi që t'i avancojnë edhe më shumë.

Fjalët kyç: planifikim gjuhësor, status i gjuhëve, norma standarde, gjuhë superiore.

Ismet OSMANI

PROBLEME KUPTIMORE NË TERMINOLOGJINË E ADMINISTRATËS PUBLIKE

Abstrakt

Terminologjia përbën një fushë specifike në leksikun e shqipes, e cila pasqyron më drejtpërdrejt zhvillimin dhe modernizimin e gjuhës së sotme shqipe dhe është e lidhur ngushtë me përparimin e arsimit, të shkencës e të kulturës, me përhapjen e njohurive tekniko-shkencore në mbarë shoqërinë shqiptare. Si e tillë, ajo luan një rol të jashtëzakonshëm për të gjitha mjeshtëritë e dijet, të cilat i huazojmë përmes përkthimit në fusha të ndryshme: gjuhësi, juridik, ekonomi, filozofi, arte, shkenca të mjedisit etj.

Zhvillimet e reja socio-ekonomike kërkojnë një përkushtim e profesionalizëm në interpretimin, përkthimin dhe përdorimin e terminologjisë së saktë qoftë juridike, ekonomike dhe në fusha të tjera. Në nxitjen dhe zhvillimin e terminologjisë duhet konceptuar politika gjuhësore koherente në mbarë trevat shqipfolëse. Termat e shumtë që hyjnë në secilën gjuhë, pra edhe në shqipen, duhet përcaktuar dhe përkufizuar mirë, të cilët do të përdoreshin në mënyrë konsekuente në të gjitha dokumentet juridiko-ekonomike, në të gjitha tekstet shkollore, profesionale e shkencore të vendeve tona.

Problem tjetër që duhet trajtuar është edhe standardizimi dhe normëzimi i termave në fusha të ndryshme të veprimtarisë njerëzore. Në të gjitha fushat, standardizimi i termave zvogëlon mundësinë e interpretimeve të ndryshme të dokumenteve.

Fjalët kyç: term, terminologji, politikë gjuhësore, terminologji administrative, terminologji ekonomiko-juridike

Berton SULEJMANI

TOPONIMIA NË TABELAT RRUGORE

Në këtë kumtesë do të trajtojmë emrat e përveçëm të qyteteve, fshatrave e lagjeve në Maqedoninë e Veriut. Shpeshherë kemi vërejtur luhatje në shkrimin e këtyre toponimeve, kryesisht në tabela rrugore, në tabela elektronike të stacioneve hekurudhore e të autobusëve.

Po i paraqes vetëm dy nga luhatjet: *Novo Sellë (maq. Ново Село) në vend që ta shkruajnë Novosellë (pashq.) Novosella (shq.); * Radishanë (maq. Радишани) për Radishan (pashq.) Radishani (shq.).

Mustafa IBRAHIMI

KONCEPTE NË SISTEMIN GJUHËSOR "BOTËROR" DHE FUNKSIONET QË KRYEN GJUHA SHQIPE NË DISA SHTETE TË BALLKANIT

Abstrakt

Përpjekje për të vënë sadopak ndonjë rend në gjithë këtë kaos gjuhësor e bëri sociologu holandez Abram de Svan, i cili në veprën e tij paraqiti konceptin ndaj sistemit gjuhësor "botëror". Sipas tij gjuhët përbëjnë pjesë të një sistemi mbarëbotëror. Çdo gjuhë prej tyre përfshinë një grup të gjuhëve lokale të lidhur me një gjuhë qendrore, zakonisht me atë gjuhë të cilën e flasin shumica e individëve bilingual (frëngjishtja, gjermanishtja, rusishtja, spanjishtja, kinezishtja, arabishtja etj.).

Sociolinguistit francez Luj Zhan Kalve (Calvet 1999), dallon 4 lloje kryesore të gjuhës. Anglishtja është e vetmja gjuhë "hiperqendrore", më tepër ka gjuhë "superqendrore" (p.sh. frëngjishtja, spanjishtja dhe portugalishtja në ish-kolonitë), shumë të tjerë janë gjuhë "qendrore" (gjuhët nacionale dhe lingua franke); të gjithë të tjerët janë gjuhë "periferike" (gjuhët amtare pa status zyrtar dhe vernakularët). Gjuhët që janë të radhitur në këtë hierarki kryejnë tri funksione kryesore – zyrtare, komunikuese dhe amtare.

Duke u bazuar në amendamentin V, paragrafi i parë, ku thuhet : "*Në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare, gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik",* ku maqedonishtja paraqitet

gjuhë zyrtare me status ekskluziv, kurse shqipja gjuhë zyrtare, por pa status ekskluziv.

Fjalët kyç: sistemi gjuhësor, koncepte, gjuhë zyrtare, gjuhë amtare, gjuhë komunikuese

Gjovalin SHKURTAJ

KUFIJTË GJUHËSORË DHE SHTETËRORË SI PROBLEM THEMELOR I POLITIKAVE GJUHËSORE NË MJEDISET DY DHE MË SHUMË GJUHË NË KONTAKT

Abstrakt

Njëgjuhësia, dygjuhësia dhe shumëgjuhësia në mjediset shoqërore të hershme dhe të rejat, janë si kapilaret e gjakut arterial dhe atij venoz në organizmin e ndërlikuar të njeriut e të qenieve të gjalla:

Emblemë të hulumtimeve për termat e mësipërm është postulati "*Kufijtë e gjuhës sime janë kufijtë e botës sime*" i Ludvig Witgensteinit, si njëri nga konceptet themelore të gjuhësisë së përgjithshme dhe të sociolinguistikës. **Gjuhët dhe kulturat e ndryshme, sidomos kur u përkasin pakicave etnike të veçanta, duhet të ruhen e të mbrohen dhe jo të nxiten drejt zhdukjes".(** Gj.Shkurtaj, *Sociolinguistikë e shqipes, Nga dialektologjia te etnografia e të folurit*, Botim i dytë, Tiranë, 2009, f. 77).

Krijimi i shteteve të mëdha ballkanike ka shkaktuar mospërkime të shumta midis kufijve etnikë e gjuhësorë dhe atyre politikë të shqiptarëve, në mënyrë që, një pjesë e madhe e trojeve dhe e popullsisë shqiptare të mbeteshin në shtetet e huaja fqinje, si në ish- Jugosllavi : Kosova, trevat shqiptare të Malit të Zi, të Maqedonisë së Veriut dhe të Serbisë Jugore; në Greqi: gjithë Çamëria, d.m.th. trevat shqiptare që nga Konispoli e deri në Prevezë.

Në të gjitha këto bashkësi shqipja na shfaqet edhe si *gjuhë në kontakt*, d.m.th. si gjuhë pranë (apo krahas) një gjuhe tjetër, duke qenë shqipja *gjuhë e parë* (L1**),** kurse gjuha e huaj *e dytë* (L2). Këtë idiomë ata e mësojnë nga nënat e tyre dhe e flasin në shtëpi, në gjitoni e kudo me shqiptarë apo arbëreshë.

Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, ndonëse janë pakicë gjuhësore e etnike, po kërkojnë e po punojnë me ngulm për mbrojtjen e shqipes zyrtarisht, duke krijuar e jetësuar edhe *Inspektoratin Gjuhësor për Mbrojtjen dhe Zbatimin e Gjuhës Shqipe.* Kjo është një nismë shumë e vlefshme dhe që duhet përshëndetur e mbështetur me të gjitha mundësitë që kemi. Këtë e kam shprehur në mbledhjen e fundvitit në Akademinë tonë të Shkencave, si dhe në disa intervista në mediat e shkruara e të folura.

Fjalët kyç: kontakt, njëgjuhësi, shumëgjuhësi, gjuha e pakicës

PJESËMARRËSIT E KONFERENCËS

Izer MAKSUTI, mësimdhënës në Universitetin "Ukshin Hoti" - Prizren dhe në Universitetin e Tetovës, në Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane.

Ajten HAJDARI-QAMILI, mësimdhënese në Fakultetin e Filologjisë "Bllazhe Koneski" – Shkup, Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare

Petra MALFERTHEINER, studiuese në Institutin për Federalizëm Krahasues në Hulumtimin, Eurac në Bolzano/Bozen, Itali. Duke pasur një diplomë master në studime të përkthimit nga Universiteti i Insbrukut, prejardhja e saj përfshin gjithashtu përvojë si asistente parlamentare në Senatin e Republikës Italiane dhe në Parlamentin Evropian, Itali

Besim KABASHI, mësimdhënës në Universitetin Friedrich-Alexander i Erlangen-Nurembergut, Gjermani

Andrea ABEL, Instituti për Zbatimin e Gjuhëve, programi për hulumtime "Eurac", Itali

Emil LAFE, gjuhëtar dhe mësimdhënës në Universitetin e Tiranës. Ka punuar dhe në Institutit e Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Akademisë së Shkencave. Ka qenë drejtor i Qendrës së Enciklopedisë Shqiptare,.

Rami MEMUSHAJ, gjuhëtar, mësimdhënës në degën e gjuhës së gjuhës dhe të letërsisë shqipe në Universitetin e Tiranës.

Zeqirija IBRAHIMI, punonjës shkencor në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup.

Veronika KAREVA, mësimdhënëse në Universitetin e Evropës Juglindore, Tetovë

Dimitar PANDEV, mësimdhënës në Universitetin "Shën Kirili dhe Metodij"

Klara KRANEBITTER, hulumtuese pranë Institutit për gjuhësi të aplikuara

Anila OMARI, mësimdhënëse në Universitetin e Tiranës, Republika e Shqipërisë

Brikena KADZADEJ, mësimdhënëse në Universitetin e Tiranës, Republika e Shqipërisë

Edlira BUSHATI, mësimdhënëse në Universitetin e Shkodrës, Republika e Shqipërisë

Asllan HAMITI, mësimdhënës në Fakultetin e Filologjisë "Bllazhe Koneski" – Shkup, Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare.

Ismail HAMITI, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Sektori i Përkthimit

Adnan JASHARI, mësimdhënës në Universitetin e Evropës Juglindore

Mimoza KORE, mësimdhënëse në Universitetin e Tiranës, Republika e Shqipërisë

Jusuf ZEJNELI, mësimdhënës në Universitetin e Tetovës

Qemal MURATI, punonjës shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës dhe në ITSHKSH – Shkup.

Vebi BEXHETI, studiues i Gjuhës dhe i Letërsisë shqiptare

Josipa RIZANKOSKA, doktore e shkencave politike, komparative dhe politikës evropiane, autore e botimit "Vlerësimi i ndikimit të rregullativës për përdorim të gjuhëve në Maqedoni"

Jasmina TRAJKOSKA - NAUMOSKA, mësimëdhënëse në Universitetin FON

Shaban SINANI, Sekretar Shkencor i Akademisë së Shkencave, Republika e Shqipërisë

Haki YMERI, studiues i Gjuhës dhe i Letërsisë shqiptare

Demush BAJRAMI, mësimdhënës në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit në UEJL.

Emin AZEMI, publicist

Sejdi GASHI, punonjës shkencor pranë Institutit Albanologjik, Prishtinë, Dega e Gjuhësisë

Ismet OSMANI, mësimdhënës në Fakultetin e Filologjisë "Bllazhe Koneski", Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare - Shkup

Berton SULEJMANI, mësimdhënës në Universitetin e Tetovës

Mustafa IBRAHIMI, mësimdhënës në Universitetin "Nënë Tereza" - Shkup

Gjovalin SHKURTAJ, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

342.725(048.3)
81'272(4)(048.3)
811.18'27:340.13(497.7)(048.3)

SHUMËGJUHËSIA dhe sfidat e zbatimit të ligjit të përdorimit të gjuhëve në RMV : libri i abstrakteve. - Shkup : Agjencia për zbatimin e gjuhës e RMV-së, 2020. - [64] стр. ; 25

ISBN 978-608-66482-0-6

а) Јазични права - Апстракти б) Јазична политика - Употреба на јазикот - Европа - Апстракти в) Албански јазик - Употреба - Законска регулатива - Македонија - Апстракти COBISS.MK-ID 112214538

ISBN 978-608-66482-0-6